



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË

Nr. 529/ Prot.

7

Tiranë, 04/05/2021

URDHËR

Nr. 330, Datë 04.05.2021

**“PËR MARRJEN E MASËS DISIPLINORE VËREJTJE ME PARALAJMËRIM PËR
HEQJEN E LICENCËS PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT NDAJ NOTERES
FATBARDHA MURRA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 18/1, nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 98 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe pikës 2/b, të nenit 26, të ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 “Për noterinë”.

KONSTATOJ:

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.371, datë 09.11.2020, “Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noteres Fatbardha Murra”, grupi i inspektimit i përbërë nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë, në datat 16.11.2020 - 17.11.2020, ushtroi kontroll pranë zyrës të noteres Znj.Fatbardha Murra. Në përfundim të analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, objekt i kontrollit administrativ, grupi i kontrollit vlerësoi se:

- Noterja Fatbardha Murra e ushtron veprimtarinë noteriale në Bashkinë Bulqizë, në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 4450, datë 22.06.2005.
- Noterja Fatbardha Murra, gjatë veprimtarisë noteriale respekton pjesërisht kërkesat e ligjit nr.110/2018 ‘Për noterinë’ dhe të akteve nënligjore në fuqi që dispiplinojnë veprimtarinë noteriale në Republikën e Shqipërisë.
- Në ditën e parë të kontrollit, në datë 16.11.2020, në regjistrin manual të akteve dhe veprimeve noteriale u gjenden faqe regjistri me numra të lëna bosh, të paplotësuara. Në ditën e dytë të kontrollit, në datë 17.11.2020, noterja Znj.Fatbardha Murra ka plotësuar të gjitha numrat e lëna bosh me numrin e akteve dhe veprimet noteriale të kryera, si dhe të gjitha rubrikat përkatëse sipas formatit të regjistrin manual. Nga verifikimi rezultoi se noterja kishte realizuar rregullisht regjistrimin e këtyre akteve në Regjistrin Noterial Shqiptar (RNSH).
- Në ditën e parë të kontrollit, në datë 16.11.2020, grupi i kontrollit konstatoi se noterja Znj. Fatbardha Murra, nuk e kishte kryer pagesën e kontributit për sigurimin e detyrueshëm profesional. Në ditën e dytë të kontrollit, në datë 17.11.2020, noterja ka plotësuar këtë kërkesë,

- në zbatim të pikës 1/g të nenit 21, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”. Po ashtu në ditën e dytë të inspektimit rezultojnë të kryera pagesat e sigurimeve shoqërore, pagesat e tatimit mbi fitimin, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet financiare që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Noterja Fatbardha Murra nuk ka plotësuar kërkesat e pikës 9 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.157, datë 02.06.2020, “Për miratimin e kriterëve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit”, lidhur me vendosjen e tabelës së përmasave 0,6x1 metra në fasadën e zyrës, në të cilën duhet të shënohen fjalët “NOTER” dhe emri e mbiemri i noteres që ushtron aktivitetin.
 - Noterja Znj.Fatbardha Murra ka vepruar në pakujdesi të rëndë në përpilimin e dy akteve noteriale, konkretisht në *kontratën* e dhurimit pasuri e paluajtshme, Nr.1418 rep, Nr.290 kol, datë 07.10.2020 dhe *kontratën* e huasë Nr.1196 rep, Nr.375 kol, datë 13.07.2017, veprime të cilat përbëjnë një risk të lartë sa i takon masave parandaluese për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe në pakujdesi të lehtë në përpilimin e dy akteve noteriale, konkretisht: në dëshminë e trashëgimisë testamentare Nr.1304 rep, Nr.361 kol, datë 13.07.2018 dhe në dëshminë e trashëgimisë ligjore Nr.1330 rep, Nr. 371 kol, datë 19.07.2018.
 - Sipas ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se subjektet duhet të raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi, noterja Znj.Fatbardha Murra ka mangësi në kryerjen e raportimeve të rregullta. Konkretisht, lidhur me dy akte noteriale: *kontratë* dhurimi pasuri të paluajtshme, Nr.1418 rep, Nr.290 kol, datë 07.10.2020, *kontratë* huaje Nr.1196 rep, Nr.375 kol, datë 13.07.2017 dhe kujdesit që duhet treguar mbi dyshimin e arsyeshëm që mund të lindë nga analiza e përmbajtjes e tyre, vlerësojmë se nuk janë zbatuar plotësisht detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për periudhën 2015-2020.

Duke zbatuar parashikimin ligjor se masa disiplinore e dhënë ndaj një noteri jepet në proporcion me shkeljen dhe bazohet në disa kriterë, konstatohet se noterja nuk ka masë disiplinore të mëparshme, krijon një dëm të mundshëm nga këto shkelje dhe duhet të kishte marrë masat e nevojshme për evitimin e veprimeve me risk.

PËR KËTO ARSYE :

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 18/1, nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 98 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe pikës 2 gërma “b”, të nenit 26, të ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 “Për noterinë”, për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe veprimtarinë e noterit,

URDHËROJ :

1. Marrjen e masës disiplinore vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, ndaj noteres Znj.Fatbardha Murra.

2. Noterja Znj.Fatbardha Murra të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.157, datë 02.06.2020, "Për miratimin e kriterëve të hollësishme për mjedisin e zyrës së noterit".
3. Noterja Znj.Fatbardha Murra të marrë të gjitha masat për sistemin, organizimin dhe klasifikimin e dokumentacionit arkivor, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri.
4. Noterja Znj. Fatbardha Murra të marrë të gjitha masat për përmbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e pagesave në kohë, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, që lidhen me ushtrimin e rregullt të veprimtarisë noteriale, si pagesat e sigurimeve shoqërore, pagesat e tatimit mbi fitimin, tatimit mbi vlerën e shtuar, si dhe detyrimet financiare që lidhen me veprimtarinë profesionale, si pagesën e sigurimit mbi përgjegjësinë profesionale, kuotat e ndaj Dhomës Kombëtare të Noterisë, brenda afateve përkatëse.
5. Ndaj këtij urdhri mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
7. Ky Urdhër i njoftohet Dhomës Kombëtare të Noterisë, Degës Vendore Tiranë dhe noteres Znj.Fatbardha Murra.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

